



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:049830

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05870285

Ac.nr.4350/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Halide Reka, dhe Nora Billaca Dula, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.K.U., nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Z.B., avokate në Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Ferizajit-Drejtoria Komunale e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me objekt të kontestit pagesa e shujtave ditore dhe udhëtimit, duke vendosur lidhur me ankesën paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.428/21, të datës 24.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses D.K.U., nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.428/21, i datës 24.02.2022, në pikën I të dispozitivit, në pjesën ku është vendosur për shpenzimet e procedurës kontestimore, **VËRTETOHET**.

II. Pika I e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.428/21, të datës 24.02.2022, në pjesën ku është vendosur për detyrimin e të paditurës për pagesën e shujtave ditore, shpenzimeve për udhëtim dhe kamatën ligjore, si dhe pika II e dispozitivit, mbeten të pashqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.428/21, të datës 24.02.2022, ka vendosur si në vijim: “I. APROVOHET si e themeltë kërkesëpadia e paditëses D.K.U. nga Prishtina, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj - Drejtoria e Arsimit që paditëses ti paguaj shumën e përgjithshme prej 278.80 € (dyqind e shtatëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë cent) dhe atë në emër të shujtës ditore për 68 ditë nga data 13.03.2020 deri më datë 22.01.2021 ti paguaj shumën prej 136€, si dhe për udhëtim shumën prej 142.80 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 98 € (nëntëdhjetë e tetë euro) të gjitha brenda afatit prej 7 dite nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.; II. DETYROHET paditësja që të paguajë shumën prej 20 € në emër të taksës për padi në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore sa i përket vendimit lidhur me shpenzimet e procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin C.nr.428/21, të datës 24.02.2022, sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, ashtu që ta obligoi të paditurën që paditëses të ia përmbush shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për përpilimin e parashtrësës mbi precizimin e kërkesëpadisë në shumën prej 104 €, për përpilimin edhe po të kësaj ankese në shumën prej 104 €, gjithsejtë shumën e përgjithshme prej 208 €.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarës së saj, kundër të paditurës ka parashtruar padi me datën 17.03.2021, për kompensimin e shujtave ditore dhe rrugëtimit, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadijën e paditësve, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore, dhe ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.428/21, të datës 24.02.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadijën e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vërtetimet e lëshuara nga Gjimnazi "Kuvendi i Arbërit" në Ferizaj, është vërtetuar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura edhe atë si profesororeshë e fizikës, dhe se e njëjta për periudhën 13.03.2020 deri në datën 21.01.2021 ka punuar 68 ditë mësimi. Gjykata e shkallës së parë lidhur me shujtat ditore ka vendosur konform nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sipas të cilit paditësja ka të drejtë të kompensohet në shumën 2.00 € për një ditë të pranisë në punë. Ndërsa, shpenzimet e udhëtimit gjykata e shkallës së parë i ka konstatuar në bazë të çmimoreve të Sh.P.K. E. për relacionin Ferizaj – Prishtinë, si dhe për të njëjtat ka vendosur konform nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sipas të cilit paditëses i takon pagesa e shpenzimeve të rrugës në 70% të vlerës së biletës urbane. Tutje, gjykata ka arsyetuar se në kuptim të nenit 398 të LPK-së ka vendosur pa caktuar seancë gjyqësore, sepse kërkesëpadija e paditëses ishte qartazi e themeltë dhe e bazuar, ndërsa kundërshtimi i të paditurës ishte sipërfaqësor dhe i pa bazuar në prova dhe fakte. Nga këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovohet kërkesëpadijën dhe të obligojë të paditurën që paditësve t'iu kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka arsyetuar konform nenit 10 të LPK-së, nenit 22 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit i datës 23.03.2019, si dhe konform dispozitave të nenit 452.1, 453 dhe 449 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës

së parë në pjesën e atakuar që i referohet vendosjes për shpenzimet e procedurës kontestimore, nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata e Apelit, duke u bazuar në nenin 194 të LPK-së, në këtë rast aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ekzaminuar vetëm në pjesën që është goditur me ankesë nga pala paditëse, dhe ka gjetur së janë të paqëndrueshme pretendimet e paditëses së gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje procedurale kur ka vendosur për shpenzimet e procedurës. Kjo sepse gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore dhe njohjen e shpenzimeve vetëm për përpilimin e padisë dhe për taksën gjyqësore, me të drejtë i është referuar nenit 10 par.1 të LPK-së, si dhe nenit 22 par.1 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, sipas të cilëve avokati duhet të jetë i vëmendshëm kur bëhet fjalë për shpenzime dhe të mos i shkaktojë palës shpenzime të panevojshme. Për më tepër, duhet theksuar se në rastin konkret referuar nenit 486 të LPK-së kemi të bëjmë me kontest të vlerës së vogël dhe meqë është vetëm një paditës, gjykata e shkallës së parë ka përcaktuar shumat për shpenzimet procedurale konform tarifave të OAK-së. Gjykata e shkallës së parë për shpenzimet e procedurës kontestimore ka vendosur në përputhje edhe me dispozitat e nenit 449, 452.1, dhe 453 të LPK-së, pasi që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk ia ka njohur paditëses shpenzimet për precizimin e kërkesëpadisë, sepse paditësja precizimin e kërkesëpadisë ka pasur për obligim ta bëjë me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë dhe jo këtë ta bëjë me parashtesë të veçantë në mënyrë që të krijohen shpenzime shtesë të cilat nuk kanë qenë të nevojshme. Andaj, Gjykata e Apelit vendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit për shpenzimet procedura e vlerësoj si të drejtë dhe të ligjshëm.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.428/21, i datës 24.02.2022, në pikën I të dispozitivit, në pjesën ku është vendosur për detyrimin e të paditurës për pagesën e shujtave ditore, shpenzimeve për udhëtim dhe kamatën ligjore, si dhe në pikën II të dispozitivit, ka mbetur i pashqyrtuar, pasi që në këtë pjesë nuk ka pretendime ankimore nga palët ndërgjyqëse.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
Ac.nr.4350/2022, më datë 19.06.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Hysni Bardheci